

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Krimeve të Rënda - Divizioni penal, si gjykatë penale e shkallës parë,** përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi – si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të pandehurve : F.H. nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të Kodit Penal të republikës së Kosovës ( në tekstin e mëtutjeshëm KPRK-s ) të cilën e mbron sipas autorizimit av. B.K. nga ..., si dhe të pandehurit A.Q. nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Gjilan, tani të transformuar në Prokurori Themelore në Gjilan – DKR, PP.nr. 142/2016 të datës 15 07 të vitit 2016, të cilën e përfaqësoj prokurori i shtetit Afrim Shefkriu, pas mbajtjes së seancës së fundit të shqyrtimit gjyqësor, verbal dhe publik më datën 28 tetor të vitit 2016 mori dhe në prani të prokurorit të shtetit, të të pandehurve me mbrojtësinë e të pandehurës, në të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë,

## A K T G J Y K I M

### I. Të pandehurit :

**1. F.H.** nga babai V. dhe nëna F., e lindur më ... në fshatin ..., K. e ..., me vendbanim në fshatin ..., Komuna e Gjilanit, poseduese e telef. mobil ... – telefoni i bashkshortit të saj, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e martuar, nënë e tre fëmijëve të mitur, ka të kryer gjashtë klasë të shkollës fillore, me gjendje të varfër ekonomike, është shfrytëzuese e ndihmës sociale duke e argumentuar me prove në shkresa të lëndës, e pagjykauar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër saj, i tërhiqet vërejtja se është e detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të vendbanimit përkatësisht të vendqëndrimit të tij gjer në vendosjen përfundimtare lidhur me këtë çështje penale, nën kërcënim të pasojave ligjore me lëshuarje të urdhër arrestit e nëse plotësohen kushtet ligjore edhe të letër rreshtimit,

### Ë shtë fajtore

**Sepse** më datën 22 11 2013 rreth ores 15:15 minuta, në fshatin ..., Komuna e ..., pas një grindje dhe mosmarrëveshje që ka pasur me të pandehurin A.Q. nga po i njëjti fshat, ka marrë pushkën e gjuetisë të bashkshortit të saj H.H., caliber 16 mm, me numër serik ... dhe të njëjtën e ka përdor në mënyrë kërcënuese dhe frikësuese ndaj të pandehurit A.Q. duke shtënë dy here në ajër e që më pastaj me intervenimin e pjestarëve të policisë të Kosovës, e njëjta armë është sekuestruar,

-ashtu që me veprimet e tilla kriminale ka kryer veprën penale **përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2** të KPRK-s.

dhe

**2. A.Q.** nga babai A. dhe nëna Z., i lindur më ... në fshatin ..., Komuna e ..., posedues i telefonit mobil ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve,

ka të kryer shkollën e mesme, i papunësuar, me gjendje të varfër ekonomike, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij, i tërhiqet vërejtja se është e detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të vendbanimit përkatësisht të vendqëndrimit të tij gjer në vendosjen përfundimtare lidhur me këtë çështje penale, nën kërcënim të pasojave ligjore me lëshuarje të urdhër arrestit e nëse plotësohen kushtet ligjore edhe të letër rreshtimit,

### **Është fajtor**

**Sepse** në kohën dhe vendin si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi gjatë grindjes me të pandehuren F.H., paraprkisht e ka sulmuar fizikisht të njëjtën ashtu që e ka goditur me një shkop në pjesë të ndryshme të trupit, më pas e godet edhe me shuplakë në fytyrë duke e kapur për fyti, e që edhe me intervenimin e dëshmitarit Z.Z. nga i njëjti fshat arrinë ta ndaj dhe rastij raportohet në Polici,

-ashtu që me veprimet e tilla kriminale ka kryer veprën penale **sulmi** nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-s.

Gjykata në bazë të dispozitave të cituara, nenit 7,21, 41,50, 51, 52, 53, 54, 69 73,74 dhe 75 të KPRK-s, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedures Penale ( KPP-s ) të akuzuarve në fjalë,

### **J u s h q i p t o n**

-Të pandehures **F.H. dënim me burgim** në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjetë ( **180** ) **ditëve si dhe dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) Euro**, duke urdhruar në të njëjtën kohë që këto dënime komulative mos të ekzekutohen, nëse e pandehura gjatë afatit verifikues prej një ( 1 ) viti e gjashtë ( 6 ) muaj, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryenë vepër tjetër penale, **nën kërcënim të revokimit të tij në kuptim të nenit 45 dhe 46 të KPK-s** kurse

-Të pandehurit **A.Q. dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë ( 60 ) ditëve**, duke urdhruar në të njëjtën kohë që ky dënim mos të ekzekutohet, nëse i akuzuari gjatë afatit verifikues prej një ( 1 ) viti, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryenë vepër tjetër penale, **nën kërcënim të revokimit të tij në kuptim të nenit 45 dhe 46 të KPK-s**

**II. Në kuptim të nenit 60 lidhur me nenin 375 paragrafi 3 të KPRK-s** të pandehures i shqiptohet dënimi plotësues duke ju konfiskuar një pushkë e gjuetisë prone e bashkshortit të të akuzuares, me caliber 16 mm dhe me numër serik ..., e cila nga ana e komisionit të posaçëm do të shkatërrohet duke u konstatuar me procesverbal.

**III. DETYROHEN të pandehurit** në fjalë që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi paushallin gjyqësor në shumën prej nga **tridhjetë ( 30 ) Euro**, në afat prej pesëmbëdhjetë ( 15 ) ditëve nga disa e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria kompetente kundër të pandehurve në fjalë ka ngritur aktakuzë për shkak të dyshimit të bazuar mirë se kanë kryer veprat penale lëndore.

Sipas dispozitave të Ligjit mbi gjykatat kompetencë lëndore për vendosjen e lëndës penale përkitazi me veprën penale nga neni 275 paragrafi 2 të KPRK-s nuk është paraparë Departamenti i krimeve të Rënda, e kjo nuk është paraparë as me dispozitën nga neni 22 paragrafi 1 nënparagrafi 1.75 të KPP-s. Në rastin konkret Departamenti i krimeve të rënda i kësaj gjykate është shpallur jo kompetentë në pikëpamje lëndore për

zgjidhjen e kësaj lënde penale edhe atë me aktvendim duke dhënë arsyet ligjore. Gjyqtari i Departamentit të Përgjithshëm i kësaj gjykate me një parashtrësë të datës 19.09 2016 duke ju drejtuar Zyrës Qendrore për regjistrimin e lëndëve ka kërkuar që lëndën e tillë t'ia kthej departamentit për krime të rënda të kësaj gjykate nëse ka filluar procedura gjyqësore. Në rastin konkret, pai që kemi të bëjmë me vepër penale për të cilën nuk është paraparë kompetenca lëndore ekskluzive e Departamentit për krime të rënda edhe atë as me Ligjin për gjykatat e as me Kodin e procedurës penale gjer në vendosje përfundimtare ky departament mund të vendos për shpalljen e inkompetencës lëndore, bile jo vetëm me aktvendim por edhe me aktgjykim refuzues varësisht se në cilën faze ka arritur procedura penale.

Në kuptim të nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit për gjykatat kompetentë për vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës mes departamentet e të njëjtës gjykatë si në rastin konkret është kryetari i Gjykatës Themelore përkatëse e në këtë rast të asaj në Gjilan. Përkundër kësaj pa vendosur kryetari i gjykatës lënda vetëm në bazë të parashtrësës se gjyqtarit të Departamentit të Përgjithshëm i është dorëzuar kryetarit të trupit gjykues të kësaj gjykate. Me qëllim që mos të pësoj pala me fajin e dikujt që nuk vepron me kompetencë, kryetari i trupit gjykues ka vendos që ta procedoj lëndën, mirëpo në të ardhmen nuk do të toleroj sjellje të tilla pa kompetencë.

Kryetari i trupit gjykues ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar duke i ftuar palët por edhe mbrojtësinë e të pandehurës av. B.K. nga ....

Kryetari i trupit gjykues pasi që të pandehurit i ka njoftuar me të drejtat e tyre konform dispozitave ligjore, e pandehura e parë është konsultuar me mbrojtësin e saj, dhe me vetëdije të plotë dhe vullnet të lire ka pranuar fajësinë e këtë nuk e ka kundërshtuar as mbrojtësi e as prokurori i shtetit. Po ashtu edhe i pandehuri i dytë e ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndore.

Kryetari i trupit gjykues me aktvendim procedural ka vendosur që të aprovoj pranimin e fajësisë për veprat penale lëndore nga ana e të pandehurve në fjalë, duke vazhduar seancën me deklaratat e palëve për të vërtetuar faktet relevante lidhur me dënimet ndaj të pandehurve.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga ana e dy të pandehurve është i plotë dhe në përputhje me provat materiale. Mirëpo, me rastin e matjes së dënimit gjykatës i ka propozuar që të ketë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, gjendjen familjare të të dy të pandehurve, faktin se më parë nuk kanë qenë të dënuar, duke konsideruar se ka vend për zbutjen e dënimit nga neni 75 dhe 76 të KPRK-s.

Mbrojtësi i të pandehurës av. B.K. përkitazi me të pandehurën F.H. gjykatës i ka propozuar që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese edhe atë pranimin e fajësisë, keqardhjen e shprehur nga e mbrojtura e tij lidhur me ngjarjen penale, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëritë veprime të tilla, duke u propozuar gjykatës që të shqiptoj një dënim të kushtëzuar me bindje se edhe me një dënim të tillë mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit.

E pandehura ka deklaruar se e pranon mbrojtjen avokastit të saj duke premtuar se me përpjekje maksimale nuk do të kontribuoj për kryerjen e ndonjë veprë penale dhe si grua do të kujdeset për familjen e saj duke ju shmangur çdo problem pa marrë parasysh çfarëdo natyre është.

I pandehuri A.Q. gjykatës i propozoj që me rastin e vendosjes t'i merr parasysh rrethanat lehtësuese edhe atë pranimin e fajësisë, pendimin e sinqert por edhe premtimin serioz se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale duke ju zotuar se do ti shmangët çdo problem pa marrë parasysh natyrën e tij duke kërkuar nga e pandehura që të jetë e disiplinuar pasi që me të njëjtëmn jeten në një fshat dhe mundësit për të kontaktuar janë të pashmangshme, duke shtuar se do t'i kthehet familjes së tij të cilën e mban me mundi të madh. Gjykatës i ka propozuar që t'ioa shqiptoj mundësisht ndonjë dënim me kusht,

duke pasur mirëkuptim edhe ndaj prokurorit i cili ka përmendur rrethanat lehtësuese dhe zbutjen e dënimit.

Gjykata për mos me e mbështet aktgjykimin vetëm në pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, ka vlerësuar provat në shkresa të lëndës duke vërtetuar gjendjet faktike si në dy pikat e dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke pasur parasysh gjendjet faktike të vërtetuar më lartë sipas provave në shkresa të lëndës, ka vërtetuar se në veprimet e të pandehurës F.H. ekzistojnë tiparet e veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK-s kurse në veprimet e të pandehurit ekzistojnë tiparet e veprës penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-s, duke i shpallë të njëjtit fasjtorë për veprat penale referente dhe dënuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vërtetuar elementet objektive të veprës penale lëndore përkitazi me të pabndehuren F., e të cilat nuk i ka kundërshtuar as e pandehura, por edhe elementin subjektiv i cili konsiston në dashje direkte. Po ashtu gjykata ka vërtetuar edhe përkitazi me të pandehurin A. elementet objektive të veprës penale lëndore të cilat nuk i ka kundërshtuar as i pandehuri por edhe elementin subjektiv i cili konsiston në dashje direkte. Po ashtu gjykata nuk ka gjetur ndonjë provë në shkresa të lëndës e as që kanë ofruar ndonjë provë itë pandehurit e as mbrojtësi i të pandehures së parë në bazë të të cilave do të përjashtohet përgjegjësia penale apo se do të vërtetohej aftësia esencialisht e zvogëluar tek të njëjtit, andaj edhe është vërtetuar se të pandehurit janë penalisht përgjegjës për veprat penale lëndore, meqë ka qenë të vetëdijshëm për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tyre kriminale dhe se kanë mundur me i kontrolluar sjelljet e tilla kriminale.

Gjykata me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 73-75 të KPRK-s pati parasysh këto rrethana lehtësuese : përkitazi me të pandehurën e parë F.H. – pranimin e fajësisë, premtimin serioz se nuk do të kryej vepra penale në të ardhmen, pendimin e sinqert, gjendjen e varfër ekonomike pasi që bashkëshorti i saj është edhe shfryzëzues i ndihmës sociale sipas proves në shkresa të lëndës, se më parë nuk ka qenë i gjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, por edhe pajtimin e tyre sipas adeteve tona shqiptare. Po ashtu edhe përkitazi me të pandehurin e dytë A.Q. pati parasysh këto rrethana lehtësuese : pranimin e fajësisë, pendimin për veprimin e pamatur të tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprime të tilla të pamatura, gjendjen e varfër ekonomike, se është i pagjykuar por edhe nuk zhvillohet procedura penale duke mos përjashtuar edhe pajtimin sipas adeteve tona shqiptare, pasi që të dy palët janë zotuar se do t'i shmangen çdo provokimin mes vete meqë jetojnë në të njëjtin fshat dhe se mund të të takohen mes vete pashmangshëm duke i kryer punët e tyre jetësore. Ndërsa, për asnjërin të pandehur nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese.

Gjykata duke pasur parasysh gjendjet faktike në dy pikat si në dispozitiv të vërtetuara në bazë të provave të cilat gjenden në shkresa të lëndës të cilat edhe nuk i kanë kundërshtuar as të pandehurit në fjalë, duke pranuar fajësinë për veprimet e tyre kriminale, por edhe rrethanat e lartcekura lehtësuese të cilat përbëjnë rrethana veçanërisht lehtësuese në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPK-s, është bindur se edhe me dënimet e lartcekura me kush, mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 50 përkatësisht 41 të KPRK-s, si ndaj të pandehurve pa ashtu edhe ndaj qytetarëve potencial, duke ngritur moralin dhe forcuar detyrimin për respektimin e ligjeve penale të vendit, me të cilat mbrohen vlerat vitale të qytetarëve por edhe shqoqërisë si tërësi.

Në kuptim të nenit 69 lidhur me nenin 375 paragrafi 3 të KPRK-s të pandehures i shqipton edhe dënimin plotësues lëndor.

Gjykata në kuptim të nenit 368 të KPP-s palët i ka udhëzuar për të drejtën në ankesë por edhe të pandehurit i ka njoftuar me rëndësinë e dënimeve me kusht por edhe me kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë në mënyrë që dënimet e shqiptuara me kusht mos të revokohen.

Pasi që asnjëra prej palëve nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë pasurore juridike gjykata objektivisht nuk ka mundur edhe me vendos.

Në kuptim të nenit 454 dhe 450 të KPP-s gjykata ka vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkatësisht paushallin gjyqësor për secilin prej të pandehurve.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda  
Divizioni Penal PKR.nr. 245/2016,më dt.28 tetor të vitit 2016**

**Sekretarja juridike,**  
Kadrije Zymberi

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Aziz Shaqiri, **d.v.**

**Udhëzim për mjetin juridik:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej pesëmbëdhjetë ( 15 ) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.